

Buletini

SHTATOR 2023



Shpërndahen 380 paisje bujqësore për fermerët lipjanas

Komuna e Lipjanit ka Shpërndarë makineri bujqësore për 380 fermerë nga subvencionet e ndara nga buxheti i komunës.

Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, gjatë procesit të shpërndarjes së këtyre pajisjeve bujqësore tha se ky lloj subvencionimi ka për qëllim zhvillimin dhe avancimin e bujqësisë në Lipjan.



Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e radhës të cilën e kryesoi Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan pikat të cilat ishin të propozuara për rend të ditës.

Gjatë kësaj mbledhje janë shqyrtuar edhe shumë çështjet tjera të rëndësishme me thekës të veçantë ato që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi, bashkë me drejtoreshën Anila Reçica Llugiqi, kanë pritur në takim sportistët e klubit futbollistik, fc. Dardania- Basel 1993, me drejtor Besim Bublica.

Fc. Dardania Basel një klub i shqiptarëve në Basel të Zvicrës që po arrinë suksese dhe po i bën bashkë shumë shqiptarë në Zvicër.

Në kuadër të kësaj vizite do të zhvillohet një ndeshje miqësore në mes të fc. Dardania dhe fc. Veteranët e futbollit Lipjan.



Përurohet Plaka Përkujtimore për atdhetarin Adem Gllavica

Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti bashkë me të birin e atdhetarit Adem Gllavica, Bardhyl Selimi në prezencë të qytetarëve dhe shumë mysafirëve në fshatin Gllavicë kanë shpalosur Plakën Përkujtimore të atdhetarit, luftëtarit e Komandantit Suprem të Forcave Shqiptare të Rezistencës për shtet etnik, inxh Adem Selimi-Gllavica.



Panairi i biznesit për zhvillimin gjithëpërfshirës Ekonomik

Në sheshin “Adem Jashari” u organizua panairi i ndërmarrësisë së agrobiznesit dhe ushqimit, në të cilin morën pjesë shumë biznese të udhëhequra nga gratë dhe minoritetet nga Komuna e Lipjanit.

“Panairi shihet si mundësia më e mirë që ndërmarrësit vendorë të promovojnë produktet e tyre, andaj ne si institucion i inkurajojmë që të marrin pjesë në organizime të tilla pasi kjo i ndihmon këta ndërmarrës të lidhen me konsumatorin, gjithmonë ne do të jemi në mbështetje të ndërmarrëseve me të vetmin qëllim që ti forcojmë prodhuesit vendor” ka thënë nderë të tjera kryetari Ahmeti.



Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka aprovuar Buxhetin e Komunës së Lipjanit për vitin 2024

Kryesuesi, z. Daut Azemi, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 22-të me radhë, në të cilën me shumicë votash u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti si dhe nënkryetari z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime rreth çështjeve të ndryshme që kanë ngritur anëtarët e Kuvendit të Komunës.



QKMF-ja në Lipjan bëhet edhe me dy autokombi për pacientët e hemodializes

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan, nga është pajisur me dy autokombi për bartjen e pacienteve me hemodializë.

Kryetari Imri Ahmeti së bashku me drejtorin e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, Shkezen Hajdini, kanë dorëzuar çelësat e këtyre dy automjeteve përfaqësuesve të QKMF-së të cilat janë financuar nga buxheti i Komunës së Lipjanit.



Në sallën e Kuvendit të Komunës u diskutua “Të drejtat pronësore të grave si prioritet për Komunën e Lipjanit

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti tha se tema është e një rëndësie të veçantë dhe me prioritet për ne, ndërsa projekti i USAID në krye me drejtoreshën znj. Jennifer Ober si dhe mysafirin që është sot me ne nga Tetra Tek nga Amerika z. Jack Mekeefe të cilët i falënderoj sepse janë nder partneret kryesor në këtë fushë dhe vazhdimisht jemi të angazhuar për të krijuar lehtësira dhe rrethana administrative, por edhe faktike që do duhej të dëshmonte barazi dhe qeverisje në pronë.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka pritur në takim përfaqësuesit e klubit të futbollit të Veteranëve të Lipjanit, të cilët i kanë dhuruar një fanellë në shenjë falënderimi për mbështetjen ndaj klubit.

Kryetari Ahmeti me këtë rast falënderoi përfaqësuesit e klubit të futbollit të Veteranëve të Lipjanit, të cilëve u ka uruar suksese në të ardhmen, ai në të njëjtën kohë tha se ky klub sikurse edhe klubet tjera sportive do të kenë përkrahje të vazhdueshme nga Komuna e Lipjanit.



Kryetari Ahmeti ndanë mbi 62 mijë euro për subvencionimin e 7 klubeve sportive

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me përfaqësuesit e klubeve sportive të Komunës së Lipjanit ka nënshkruar kontratat për subvencionimin e këtyre klubeve.

Me këtë rast Kryetari Ahmeti u ka urar suksese klubeve sportive dhe tha se subvencionimi i tyre do të vazhdoj edhe në të ardhmen dhe se klubet sportive do të gjejnë përkrahje të vazhdueshme nga Komuna e Lipjanit.



Kryetari Ahmeti i gëzohet suksesit të KV “Skënderbeu” në Superkupën 2023 të Volejbollit

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur me kënaqësi fituesit e Superkupës së Kosovës në Volejboll për vitin 2023, KV "Skënderbeu", dhe i ka uruar ata për suksesin e tyre të arritur. Ai ka shprehur besimin se ky klub do të vazhdojë të sjellë suksese të tjera në të ardhmen.

"Jam shumë i gëzuar që ky trofe ka gjetur vend në Lipjan. Ne jemi krenarë për arritjet e klubeve sportive të komunës sonë andaj gjithmonë do t'i mbështesim ekipet të cilat arrijnë suksese dhe sjellin rezultate të mira. Klubi i Volejbollit Skënderbeu na bën të ndihemi krenarë për sportistët që ka," tha kryetari Ahmeti.



Kryetari Ahmeti nënshkruan Marrëveshje Mirëkuptimi me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me zëvendës drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave z. Shefki Abdullahu nënshkruan Marrëveshje Mirëkuptimi për ndërtimin e objektit të ri të zjarrfikësve.

Kryetari Ahmeti falënderoi AME-në për arritjen e kësaj marrëveshjeje, e cila ka për qëllim ndërtimin e objektit të ri të zjarrfikësve.



Nderohet dëshmori i kombit Arsim Zeqiri

Një delegacion nga Komuna e Lipjanit udhëhequr nga nënkryetari i komunës, z. Diamant Bytyqi, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores së dëshmorit të kombit Arsim Zeqiri në fshatin Hallaq i Madh, me rastin e përvjetorit të tij të rënjes.



Për nder të ditës historike të Epopesë së Jezercit, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me përfaqësuesit nga Moto-Klubit "Veteranët e Zonës Operative të Nerodimes së UÇK-së", kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar "Adem Jashari".



FOTOLAJM/Dhurohet donacion me mjete didaktike për shkollat e Komunës së Lipjanit

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi shpreh falenderimin e komunës ndaj shoqërisë nga qyteti Brig i Zvicres të përfaqësuar nga Muhamer Mziu dhe Ralf Burgener. Ata nëpërmjet grumbullimit vullnetar të mjeteve, kanë dhuruar një donacion të vlefshëm me mjete didaktike për 9 shkolla të Komunës së Lipjanit, ndihmë kjo e çmuar për arsimin e fëmijëve tanë.




Komuna e Lipjanit ishte nikoqire e ditës së tretë të Simpoziumit për Sëmundjet Kronike Jo-Ngjitëse (SJN) në Kosovë, i organizuar nga projektet e SDC-së AQH dhe IHS.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti tha se është kënaqësi dhe nder i veçantë që në Lipjan po zhvillohet dita e tretë e këtij simpoziumi.

“Kjo ngjarje për ne është e rëndësishme së veçantë, pasi sëmundjet Kronike Jo - Ngjitëse vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për shëndetin publik në mbarë botën. Ne duhet të vazhdojmë të bëjmë hapa të rëndësishëm në luftën tonë të vazhdueshme kundër këtyre sëmundjeve, duke siguruar që komunitetet tona të gëzojnë shëndet të përmirësuar dhe një të ardhme më të ndritshme” tha kryetari Ahmeti.



Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë